

Episodi i dt. 02.09.2021

Për kontrollin e territorit në dt. 02.09.2021 ka dalë urdhri i DVP Gjirokastrë nr. 1089/b, dt. 01.09.2021 ku për kontrollin e vendit të quajtur "Burimi i Qafave" në fshatin Kolonjë është formuar grupi si më poshtë:

- Hajdin Musaraj - Specialit i krimeve per zonen (opgj) – Pergj. grupi;
- Edmond Late - Nd/Spec. per krimet (perdorues i dronit policor) – Anëtar;
- Geraldo Nelaj – SPZ Nj. Adm. Picar – Anëtar;
- Leonard Divintari – Oficer nga DVP Gjirokastrë - Anëtar;
- Ilir Malaj – Punonjës SHCBA – Anëtar.

Grupi i mësipërm në vendin e quajtur "Burimi i qafave" në fshatin Kolonjë në koordinatën 40.142054, 20.001150 pas kontrollit me dron ka konstatuar një terren të hapur rishtazi me rreth 40 bime narkotike cannabis sativa me gjatës 50-70 cm. Megjithëse janë kryer veprimet procedurale nuk është vijuar me krehjen e mëtejshme të territorit në këtë zonë apo në ditët në vijim, pavaresisht zonës me risk të lartë në kuptim të Urdhrit nr. 484, dt. 16.05.2018 te DPPSH "Për parandalimin, hetimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike". Shefi i Komisarariatit Besnik Lila dhe Shefi i Krimeve Leonard Hide nuk kanë ndjekur në vijimësi rastin dhe as kanë kërkuar rikontroll në ditët në vijim të zonës përreth.

Referuar Urdhrit te DPPSH Nr. 484, dt. 16.05.2018 "Per parandalimin, hetimin dhe goditjen e veprimtarise kriminale te kultivimit te bimeve narkotike" pika 3.3 gjate kontrollit te territorit kur konstatohen bime narkotike te kultivuara nder te tjera duhet te kryhet kontrolli i territorit ne nje rreze prej 1 km si dhe duhet te identifikohet poseduesi i parceles se kultivuar. Referuar pikave 3.5 dhe 3.7 te urdhrut te mesiperem raportit i kontrollit i dorezohet Shefit te Komisarariatit dhe atij te Krimeve per tu administruar. Veprimet e kerkuara nga pika 3.3 e urdhrut te mesiperem nuk jane kryer as nga grupi kontrollit ne terren dhe as jane kerkuar ne vijimesi nga zinxhiri komandues i Komisarariatit (Shef Komisariatit dhe Shef Krimesh) pasi jane vendosur ne dijeni.

Episodi i dt. 10.09.2021

Për kontrollin e territorit në dt. 10.09.2021 ka dalë urdhri i Kom. Pol. Gjirokastrë me nr. 73/b-101, dt. 10.09.2021 ku për kontrollin e Njësisë Adm. Cepo, ku përfshihet zona e Panjës Zhulat është ngritur grupi me përbërje:

- Hajdin Musaraj - Specialit i krimeve per zonen (opgj) – Pergj. grupi;
- Marenglen Dina – Nd/Spec. per krimet i zones (agjent i pol. gjyq.) – Anëtar;
- Edmond Late - Nd/Spec. per krimet (perdorues i dronit policor) – Anëtar;
- Geraldo Nelaj – SPZ Nj. Adm. Picar – Anëtar;



Për ditët konkrete të kontrollit të territorit do të dilte urdhri i ditës me personat konkretë që do të ishin në përbërje të grupit të kontrollit së bashku me zonat ku do të kryhej kontrolli i territorit.

#### Episodi i dt. 02.06.2021

Për kontrollin e territorit në dt. 02.06.2021 ka dalë urdhri i DVP Gjirokastrë Nr. 627/b, dt. 01.06.2021 dhe nr. 627/b-1, dt. 01.06.2021 ku përcaktohen detyrat, personat përgjegjës dhe grupet e kontrollit në terren. Për zonën e Panjës, fshati Zhulat, Nj. Adm. Cepo u krijua grupi i kontrollit me përbërje:

- *Klodian Elmazi* – Oficer në DVP Gjirokastrë – Përgj. Grupi;
- *Hajdin Musaraj* - Specialist i krimeve për zonën (opgj) – Anëtar;
- *Marenglen Dina* – Nd/Spec. për krimet e zonës (agjent i pol. gjyq.) – Anëtar;
- *Edmond Late* - Nd/Spec. për krimet (përdorues i dronit policor) – Anëtar;
- *Geraldo Nelaj* – SPZ Nj. Adm. Picar;
- *Abedin Novi* – Ne mbështetje.

Grupi i mësipërm ka evidentuar në zonën e “Panjës” Zhulat, terren të hapur me gropa por pa bimë të kultivuara. Kontrolli është ushtruar me dron por jo fizikisht. Për këtë episod drejtuesi i grupit Klodian Elmazi sqaron në deklaratimet e tij se gropa janë konstatuar me dron dhe nuk janë evidentuar fizikisht pasi duhet të kryheshin kontrole të tjera në territor. Kontrolli i mëtejshëm i tyre duhet të ndiqej në vijimësi nga seksioni i krimeve në Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë.

Në të vërtetë nga ana e Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë nuk është kryer asnjë veprim në vijimësi. Vetë oficeri i krimeve të zonës Hajdin Musaraj dhe agjenti Marenglen Dine nuk kanë çelur asnjë dosje gjurmimi dhe as kanë kryer veprime procedurale referimi në prokurori për rastin. Shefi i Komisarariatit Besnik Lila dhe Shefi i Krimeve Leonard Hida nuk kanë ndjekur në vijimësi rastin dhe as nuk është ushtruar kontroll në terren me këmbë për të verifikuar nëse terreni ka qënë me gropa të hapura rishtazi apo me gropa të vjetra. Në të njëjtën kohë specialisti Geraldo Nelaj ka qënë në zonën ku nuk është kompetencë e tij por e spz Indrit Duro i cili është mënjanuar nga kontrolli i territorit së bashku me përgjegjës të grupit Julian Qibini.

Referuar Urdhrit të DPPSH Nr. 484, dt. 16.05.2018 “Per parandalimin, hetimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike” pika 3.6 parashikohet se në rastet kur nuk konstatohen bimë narkotike përpilohet urdher për aktivizimin me shtetë të punësve të policisë, ushtrohet kontroll në zonën e përcaktuar si dhe përgatitet informacion për sektorin e krimeve në DVP. Sa më lart nga zinxhiri komandues i Komisarariatit Gjirokastrë (Shef Komisarariatit dhe Shef Krimesh) nuk është kryer asnjë prej veprimeve të mësipërme, as është ushtruar kontroll në zonën ku është konstatuar terreni me gropa të hapura gati për mbjellje dhe as nuk është përgatitur informacion për rastin.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR

**Y E N D I M**

**PËR SHPALLJEN E MOSKOMPETENCËS LËNDORE**

Në Gjirokastrë, më 12.06.2023

Unë, Gazmend Frëngu, Prokuror në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, pasi shqyrtova aktet e procedimit penal nr. 482, dt. 08.10.2021 regjistruar për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës" kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 e 25 të Kodit Penal,

**KONSTATOVA:**

Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat ka referuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë një material procedural në ngarkim të disa punonjësve të policisë së Komisarariatit Gjirokastrë të cilët në periudhën Maj-Shtator të vitit 2021 me dashje dhe me mosveprim kanë favorizuar persona të pa identifikuar në kultivimin e bimëve narkotike në zonën e "Panjës" Zhulat dhe në zonën e Kolonjës në vendet e quajtura "Burimi i Qafave" dhe "Lugu i gjatë". Konkretisht në kuadër të luftës kundër kultivimit të bimëve narkotike Drejtori i DVP Gjirokastrë pas miratimit të planit të masave ka nxjerrë Urdhrin e DVP Nr. 235/b-1, dt. 11.02.2021 me të cilin janë krijuar grupet e komandimit të kontrollit të territorit në rang drejtorie dhe në rang komisaratesh, ku në Komisaratin e Policisë Gjirokastrë kryetar i grupit ka qënë Shefi i Komisarariatit të kohës **Besnik Lila**. Ky i fundit në mbështetje të urdhrin të DVP Gjirokastrë ka nxjerrë Urdhrin Nr. 176/b-2, dt. 05.05.2021 për përcaktimin e grupeve të kontrollit në zonat konkrete që mbulon kompetenca territoriale e Kom. Pol. Gjirokastrë. Për njësitë administrative Cepo dhe Picar, ku përfshihen zonat ku është favorizuar kultivimi i bimëve narkotike (**Panja, Zhulat dhe Lugu i gjate, Kolonje**), është krijuar grupi i kontrollit i përbërë nga punonjësit e policisë:

- *Julian Qibini* – Shef i Policimit ne komunitet - Përgjegjës grupi;
- *Hajdin Musaraj* – Specialit i krimeve per zonen (opgj) – Anëtar;
- *Marenglen Dina* – Nd/Spec. per krimet i zones (agjent i pol. gjyq.) – Anëtar;
- *Edmond Late* - Nd/Spec. per krimet (perdorues i dronit policor) – Anëtar;
- *Indrit Duro* – SPZ Nj. Adm. Cepo (perfshin zonen e quajtur Panja, Zhulat) – Anëtar;
- *Geraldo Nelaj* – SPZ Nj. Adm. Picar (perfshin zonen Lugu i gjate, Kolonje) – Anëtar;
- Nje punonjes i patrolles së përgjithshme;
- Nje punonjës policie nga DVP/SHCBA.



6  
gjurmimi apo nuk kanë verifikuar terrenin në thellësi apo të marrin informacione operative për zonën. Më flagrante është zona e Panjës, Zhulat ku nga i njëjti pozicion që është ngritur droni në kontrollat e dt. 02.06.2021 e 10.09.2021 nga agjenti i krimeve Edmond Late është ngritur edhe në dt. 22.09.2021 nga oficeri Klodian Elmazi i cili ka gjetur 2 terrenet me sipërfaqe të konsiderueshme.

Në të njëjtën kohë strukturat e hetimit të krimeve të drejuara nga Leonard Hide në asnjë rast nuk kanë ndjekur me hetime të mëtijshme të dhënat e evidentuara në raportet e shërbimeve të dt. 02.06.2021, 02.09.2021, 10.09.2021 që ju takonin zonave Panjë, Zhulat dhe Kolonjë, nuk kane perçiluar informacione per DVP Gjirokaster, nuk kane evidentuar pronarin/poseduesin e parcelave si dhe nuk kane ushtruar rikontrolle ne territor.

Sa më sipër rezulton se shtetasit Besnik Lila, Leonard Hide, Hajdin Musaraj, Marenglen Dine, Edmond Late dhe Geraldo Nelaj në bashkëpunim me njëri-tjetrin, me mosveprim, kanë favorizuar persona të pa identifikuar ne kultivimin e bimëve narkotike.

Në analizë të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale rezulton se kompetenca e Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar bazohet në dy kritere, llojet e veprave penale dhe subjektet e përfshira. **Shtetasi Leonard Hide me vendimin nr. 558, dt. 23.05.2023 te Komisionit Shtetror te Zgjedhjeve eshte zgjedhur Kryetar i Bashkise Libohove ne Qarkun Gjirokaster.** Meqënëse vepra penale e dyshuar përfshin një Kryetar Bashkie te zgjedhur, referuar nenit 75/a gërma "c" të Kodit të Procedurës Penale, kompetente për vijimin e hetimeve është Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Për këto arsye, bazuar në nenin 28 pika 3 dhe në nenin 75/a g. "c" të Kodit të Procedurës Penale,

#### VENDOSA:

1. Shpalljen e moskompetencës lëndore për hetimin e procedimit penal nr. 482, dt. 08.10.2021 regjistruar për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës" kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 e 25 të Kodit Penal.
2. Kalimin e akteve të procedimit të mësipërm për ndjekje penale Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

PROKUROR  
GAZMEND FRËNGU

5

Nese do te respektohej Urdhri i DPPSH Nr. 484, dt. 16.05.2018 "Per parandalimin, hetimin dhe goditjen e veprimtarise kriminale te kultivimit te bimeve narkotike" pika 3.3 per kontrollin e territorit ne nje rreze prej 1 km nga vendi ku konstatohen bimet narkotike, parcelat e dt. 22.09.2021 do te ishin konstatuar qe ne dt. 10.09.2021 pasi ne rruge tokesore jane vetem >1 km larg<.

#### Episodi i dt. 24.09.2021

Në dt. 24.09.2021 grupi i kontrollit i ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka ushtruar kontroll në zonën e quajtur "Lugu i gjatë" Kolonjë, ku në afërsi të stanit të marrë me qira nga shtetasi Hysenj Hoxha është gjetur një terren me 900 gropa të hapura ku evidentoheshin qartësisht bimë të shkulura narkotike në nxitim e sipër. Vendi ku janë konstatuar 900 gropat ka qënë në koordinatën 40.149555, 19.99915.

Krahasimi i koordinatave të dt. 02.09.2021 në aplikacionin "Google Earth Pro" tregon se vendi ku është ushtruar kontroll në vendin e quajtur "Burimi i qafave" Kolonjë, me terrenin me 900 gropa të dt. 24.09.2021 në vendin e quajtur "Lugu i gjatë" Kolonjë, janë në një distancë prej >366 metrash rruge tokesore<. Përsëri në këtë episod rezulton qartë mosveprimi me dashje i strukturave të Komisarariatit të Policisë Gjirokastër për kontrollin e territorit në zonën e fshatit Kolonjë, ku edhe pse në dt. 02.09.2021 është gjetur terren me bimë narkotike nuk është ushtruar kontroll i mëtejshëm. Po ashtu nga deklaratimet e Kryeplakut të fshatit Kolonjë, vendi i quajtur "Lugu i gjatë" e merr ujin nga burimi më i afërt që është "Burimi i qafave". Berthama e grupit të kontrollit të dt. 02.09.2021, H. Musaraj, E. Late dhe G. Nela vetëm duke ushtruar kontrollin në burimin e ujit do të kishin evidentuar tubacionet e marrjes së ujit për parcelen në vendin e quajtur "Lugu i gjatë", Kolonje.

Nese do te respektohej Urdhri i DPPSH Nr. 484, dt. 16.05.2018 "Per parandalimin, hetimin dhe goditjen e veprimtarise kriminale te kultivimit te bimeve narkotike" pika 3.3 per kontrollin e territorit ne nje rreze prej 1 km nga vendi ku konstatohen bimet narkotike, parcela e dt. 24.09.2021 do te ishte konstatuar qe ne dt. 02.09.2021 pasi ne rruge tokesore jane vetem >366 metra larg<.

Në analizë të të gjithë këtyre episodeve rezulton evidente se strukturat e policisë të Komisarariatit Gjirokastër të drejuara nga shtetasi **Besnik Lila** kanë shkelur në mënyrë flagrante nenin 17 pika 1 g. "c" të Ligjit Nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit" në parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike zonat Panjë, Zhulat dhe Lugu i gjatë, Kolonjë. Konkretisht Shefi i Komisarariatit **Besnik Lila** në detyrat e tij kontrolluese në asnjë episod nuk ka urdhëruar strukturat e tij për rikontrolle në zonat ku janë gjetur terren me gropa të hapura, si në episodin e dt. 02.06.2021, apo terren me bimë cannabis sativa, si në episodet e dt. 02.09.2021 dhe 10.09.2021. Shefi i Komisarariatit **Besnik Lila** ka krijuar një bërthamë individësh në çdo kontroll të përbërë nga **H. Musaraj, M. Dine, E. Late** dhe **G. Nelaj** të cilët duke njohur terrenin kanë mënjanuar kontrollet e grupeve nga vendet ku kishte risk të lartë kultivimi (pas evidentimit të kultivimit apo gropave). Për më tepër në raste flagrante si ato të dt. 02.09.2021- 24.09.2021 ku terrenet kanë qënë vetëm 300 metra larg njëri-tjetrit **Hajdin Musaraj, Edmond Late** apo **Geraldo Nelaj** nuk kanë hapur dosje

4

Ky grup në dt. 10.09.2021 ka ushtruar kontroll në vendin e quajtur "Shtegu i lagjit në Panjë", zona "Panjë", Zhulat dhe në një terren të hapur rishtas janë evidentuar 37 gropa me bimë të kultivuara narkotike cannabis sativa ne koordinaten 40.105308, 19.582663. Terreni me bimë narkotike është gjetur në të njëjtën zonë ku është ushtruar kontrolli i dt. 02.06.2021, për të cilin ka qënë detyrim i Komisarariatit të Policisë kryerja e kontrolleve të vijueshme. Megjithëse janë kryer veprimet procedurale nuk është vijuar me krehjen e mëtejshme të territorit në këtë zonë në ditët në vijim duke patur parasysh zonën me risk të lartë në kuptim të Urdhrit nr. 484, dt. 16.05.2018 te DPPSH "Për parandalimin, hetimin dhe goditjen e veprimitarise kriminale të kultivimit të bimëve narkotike". Shefi i Komisarariatit Besnik Lila dhe Shefi i Krimeve Leonard Hide nuk kanë ndjekur në vijimësi rastin dhe as kanë kerkuar rikontroll në ditët në vijim të zonës përreth.

Referuar Urdhrit te DPPSH Nr. 484, dt. 16.05.2018 "Per parandalimin, hetimin dhe goditjen e veprimitarise kriminale te kultivimit te bimeve narkotike" pika 3.3 gjate kontrollit te territorit kur konstatohen bime narkotike te kultivuara nder te tjera duhet te kryhet kontrolli i territorit ne nje rreze prej 1 km si dhe duhet te identifikohet poseduesi i parceles se kultivuar. Referuar pikave 3.5 dhe 3.7 te urdhit te mesiperm raporti i kontrollit i dorezohet Shefit te Komisarariatit dhe atij te Krimeve per tu administruar. Veprimet e kerkuara nga pika 3.3 e urdhit te mesiperm nuk jane kryer as nga grupi kontrollit ne terren dhe as jane kerkuar ne vijimesi nga zinxhiri komandues i Komisarariatit (Shef Komisariatit dhe Shef Krimesh) pasi jane vendosur ne dijeni.

#### Episodi i dt. 22.09.2021

Në dt. 22.09.2021 është zhvilluar një operacion policor i fshehtë në bashkëpunim midis DVP Gjirokastrë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit pa përfshirë strukturat e Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë. Konkretisht kontrolli i territorit është kryer drejtpërsëdrejti në zonën e "Panjës" Zhulat, ku nga strukturat e Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë në kontrollet e dt. 02.06.2021 dhe 10.09.2021 është evidentuar fillimisht terren me gropa të hapura dhe më pas terren me 37 bime të kultivuara narkotike. Kontrolli i territorit në zonën e Panjës, Zhulat është kryer me dron, nga e njëjta pikë ku është ushtruar kontrolli i dt. 02.06.2021. Ky fakt provohet me deklarinimin e punonjësit të policisë Klodian Elmazi. Ky ka qënë oficeri i besuar nga Drejtori i Qarkut Gjirokastrë për të koordinuar punën me grupet e kontrollit të Drejtorisë së Përgjithshme. Gjatë kontrollit me dron në zonën e Panjës janë konstatuar dy parcela të kultivuara me bimë narkotike në koordinatat 40 05 48.5, 19 57 13.5 dhe 40 05 36.8 , 19 57 38.4 me gjithsej 780 bimë narkotike.

Krahasimi i koordinatave në aplikacionin "Google Earth Pro" tregon se vendi ku është ushtruar kontroll në dt. 10.09.2021 nga grupi me përgjegjës punonjës in e policisë Hajdin Musaraj është në distancë prej vetëm >1 km rrugë tokësore< nga dy parcelat e konsiderueshme me rreth 780 bime narkotike te gjetura ne dt. 22.09.2021 nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise. Kjo distancë është lehtësisht e verifikueshme me dron dhe nga grupi i kontrollit me dashje nuk është referuar për asgjesim. Shefi i Komisarariatit Besnik Lila dhe Shefi i Krimeve Leonard Hide nuk kanë ndjekur në vijimësi rastin dhe as kanë kerkuar rikontroll në ditët në vijim të zonës përreth.